



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

NJOFTIM PËR PUNËSIM

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Q.S.U “Nënë Tereza” kërkon të punësojë **1(një)** punonjës në pozicionin **Përgjegjës Sektori në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”**.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët janë:

- Arsimit i lartë, në nivelin Master Shkencor. Preferohet profili Gazetari/Shkenca Sociale/Shkenca Politike/Komunikim. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Të ketë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në profilin e kërkuar/pozicione të ngjashme;
- Të ketë mbrojtur gjuhën angleze;
- Të ketë njohuri të gjëra në lidhje me fushën e marrëdhënieve me publikun dhe legjislacionit në fuqi;
- Të ketë njohuri shumë të mira të Ligjit për të Drejtën e Informimit;
- Të ketë aftësi shumë të mira profesionale me qëllim promovimin e imazhit të Institucioni
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi;
- Të jetë i/e aftë të drejtojë/menaxhojë dhe vlerësojë punën e stafit në varësi;
- Të përmbushë me korrektësi detyrat e ngarkuara brenda afateve kohore.

Për sa më sipër, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentata në gjuhën shqipe si më poshtë:

1. Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopje e dokumentit të identifikimit (ID)
2. Curriculum vitae (CV) në gjuhën shqipe ku të jetë edhe adresa e postës elektronike (e-mail)
3. Diploma/t e arsimit të lartë, të noterizuar/a
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
5. Formulari i Vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore (link: <http://www.qsut.gov.al/rreth-nesh-8/te-punosh-me-ne/procedurat-e-marrjes-ne-pune-ne-qsut/>)
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet apo të tjera të përmendura në CV dhe që lidhen me pozicionin për të cilin aplikon.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e QSU “Nënë Tereza” duke nisur nga data **04.10.2022 ora 08:00 deri më 18.10.2022 ora 16:30.**

Komunikimi për datën dhe orën e Intervistave do të bëhet nëpërmjet **e-mail**-it në CV e kandidatëve.

Të gjithë kandidatët fitues do të rivlerësohen në fund të kontratës 3 (tre) mujore.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE